



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 642 Akti

Nr. 655 Vendimi
Tiranë, më 28.4.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu Kryesuese
Roland Ilia Relator
Genta Tafa (Bungo) Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 27.4.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Ersida Bajgora**, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoji subjektin e rivlerësimit dhe vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Ersida Bajgora, e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Ersida Bajgora, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtuar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).
2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni ka hedhur shortin në dhjetor të vitit 2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Ersida Bajgora do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Roland Ilia dhe Suela Zhegu. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Roland Ilia. Ndërsa kryesuese e trupit gjykues u caktua me mirëkuptim komisionere Suela Zhegu. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit. Më pas u vendos fillimi i hetimit administrativ me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Ersida Bajgora, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.
4. Subjektit të rivlerësimit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit, ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
5. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; si dhe vlerësimi i aftësive profesionale.
6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pas përfundimit të hetimit të thelluar administrativ për të tria kriteret e vlerësimit – vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale – në datën 24.3.2023 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Ersida Bajgora; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
7. Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja, të cilat i paraqiti në rrugë zyrtare pranë Komisionit në datën 11.4.2023.
8. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit, vendosi të ftojë znj. Ersida Bajgora në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Subjekti i rivlerësimit Ersida Bajgora u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *email* në datën 20.4.2023.

10. Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 27.4.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

11. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionet e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Ersida Bajgora kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

12. Znj. Ersida Bajgora ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

13. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

14. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

14.1 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

14.2 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

14.3 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

15. Referuar vendimit nr. 2/2017¹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë

¹“41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

16. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituara nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

17. Bazuar në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, përfundoi kontrollin e plotë të deklaratës së pasurisë dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, konstatohet se për subjektin e rivlerësimit Ersida Bajgora:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

18. Znj. Ersida Bajgora është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2007 me nr. Indeksi *** dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave privatë: para fillimit të detyrës 2015; periodike/vjetore 2015 - 2016; dhe deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

19. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (ç) deklaratimet e subjektit me anë të komunikimit elektronik; si dhe (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

20. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklaramëve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë te ky institucion, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Ersida Bajgora, pas shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*; krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhën 2015 - 2016, në raport me të dhënat në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*; shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve - gjendje *cash* dhe hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruar nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

21. Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit Ersida Bajgora ka deklaruar pasuritë, si vijon:

1. Të ardhurat

1.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar 2 burime të ardhurash:

a. Shkolla e Magjistraturës. Adresa: Rruga e Elbasanit, pranë Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minerave Tiranë. Kandidat për gjyqtar. Periudha e studimeve tetor 2013 – korrik 2015. Paga *neto* bursë: 1,232,058 lekë.

b. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Adresa: bulevardi “Gjergj Fishta”, Tiranë. Pozicioni: gjyqtar stazhier. Emëruar si gjyqtare stazhiere në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të Dekretit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, datë 13.11.2015. Përfundimi i stazhit: 15.7.2016. Paga vazhdon të akordohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë deri në emërimin përfundimtar nga KLD-ja. Paga mujore *bruto*: 131,400 lekë. Paga mujore *neto*: 80,970 lekë. Totali i të ardhurave *neto*: 839,732 lekë.

1.2 Bazuar në vërtetimin nr. *** prot., datë 18.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës, subjekti Ersida Bajgora për periudhën 2013 – 2015 ka përfutuar bursë në vlerën 1,232,058 lekë.

1.3 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka konfirmuar të ardhura në emër të znj. Ersida Bajgora për periudhën nëntor 2015 – shtator 2016 në vlerën 839,132 lekë dhe pagën për muajin dhjetor 2016 në vlerën 80,979 lekë.

1.4 Bazuar në *statement*-in e llogarisë së pagës së subjektit në “Raiffeisen Bank” rezulton se kanë kaluar pagat edhe për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2016.

1.5 “Raiffeisen Bank” konfirmon gjendje të llogarisë së pagës në datën 30.1.2017, në emër të znj. Ersida Bajgora, në vlerën 9,931 lekë.

1.6 Nga *statement*-i i bankar i llogarisë së subjektit tek “Raiffeisen Bank”² rezulton gjendje e llogarisë në datën 31.12.2016, në vlerën 8,224.3 lekë.

1.7 Të ardhurat totale nga bursa e Shkollës së Magjistraturës për subjektin dhe nga paga si gjyqtare stazhiere pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, janë në vlerën totale 2,314,130 lekë.

1.8 Komisioni konstatoi se në llogarinë bankare të subjektit janë bërë veprime financiare (depozitim shume) nga shtetasit U.F dhe E.R.B. Shtetasi E. B. rezultoi se është i ati i subjektit dhe për shkak të marrëdhënies së posaçme dhe vlerës së vogël të depozituar nuk janë konstatuar problematika. Lidhur me shtetasin U. F., Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit. Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka shpjeguar (duke vënë në dispozicion edhe deklaratën noteriale)

² Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.9.2021, të “Raiffeisen Bank”.

dhe ka paraqitur autorizim që i ka dhënë shtetases U. F. për të kryer veprime në emër të saj pranë bankës, vlera të cilat kanë shërbyer për pagesa këstesh kredie.

1.9 Në përfundim të hetimit, Komisionit nuk i rezultuan problematika për këto burime të ardhurash. Të ardhurat e deklaruara nga subjekti nga marrëdhëniet e punës kanë kaluar në llogarinë rrjedhëse bankare pranë “Raiffeisen Bank” ndër vite. Ndryshimet e likuiditeteve në këto llogari janë pasqyruar në analizën financiare.

2. Kredi bankare

2.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kreditë bankare:

a. Kredi pranë “Raiffeisen Bank”. Qëllimi i kredisë: mbulimi i shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit. Kontratë kredie nr. ***, datë 23.8.2016. Shuma e kredisë: 100,000 lekë. Kohëzgjatja: 1-vjeçare. Kësti mujor: përafërsisht 8,700 lekë/muaj. Shuma e detyrimit të mbetur: 70,433.41 lekë.

“Raiffeisen Bank”³ ka konfirmuar se në emër të znj. Ersida Bajgora rezulton kredi bankare me detyrim financiar të mbetur në vlerën -70,433 lekë, në datën 30.1.2017.

b. Institucioni kredidhënës: “Raiffeisen Bank”. Lloji kredisë: *overdraft* (kontratë kredie me kufi). Qëllimi i kredisë: mbulimi i shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit. Kontratë kredie datë 23.8.2016. Shuma e kredisë: 240,000 lekë ose tri paga/muaj. Kohëzgjatja: 1-vjeçare. Është shlyer shuma e detyrimit të mbetur 240,000 lekë. “Raiffeisen Bank” konfirmon se znj. Ersida Bajgora ka *overdraft* me detyrim të mbetur në vlerën 240,000 lekë.

2.2 Në përfundim të hetimit, Komisionit nuk i rezultuan problematika lidhur me kredinë bankare dhe *overdraft*-in tek “Raiffeisen Bank”. Veprimet lidhur me këto kredi bankare janë përfshirë në analizën financiare.

3. Pasuri në përdorim

3.1 Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme në përdorim.

3.2 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si adresë të gjendjes civile: “Lagjja ‘***’, rruga ‘***’, shtëpi private pa numër, Fier, Shqipëri (prindërit e mi kanë jetuar me qira në këtë banesë)”. Ndërkohë, subjekti ka deklaruar edhe vendqëndrim tjetër: “Lagjja ‘***’, rruga ‘***’, pallati Kullë, ap. ***, Fier, Shqipëri (ku aktualisht jetoj në shtëpinë e gjyshërve të mi)”.

3.3 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar: “Gjatë muajit gusht dhe në periudhën 24 janar 2017 - mars 2017, kam qëndruar në banesën ku jetonin prindërit e mi bashkë me vëllain në adresën ***, Fier. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe kam qëndruar edhe në apartamentin ku banonte gjyshja e ndodhur në qytetin e Fierit...”.

3.4 Lidhur me dy pasuritë e deklaruara nga subjekti

a. Pasuria apartament banimi 2+1, banesa nr. ***, shk. ***, kati ***, ndodhur në lagjen “***”, Fier (pasuria nr. ***, sip. 67.96 m²) është përfituar me anë të kontratës së privatizimit datë 15.9.1993 nga shtetasi Rr. K (gjyshi i subjektit). Privatizimi i kësaj banese është bërë nga NK Banesa, sektori i privatizimit dhe pala përfituese Rr.K. Më pas kjo pasuri është regjistruar në emër të trashëgimtarëve të shtetasit Rr. K. dhe është lëshuar edhe certifikatë për vërtetimin pronësie (datë 13.11.2015).

³ Shihni përgjigjen e “Raiffeisen Bank” në dosjen e ILDKPKI-së dhe dosjen e Komisionit.

Në datën 16.5.2014 noterja E. Sh ka lëshuar vendimin nr. ***/*** për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për të ndjerin Rr.K. Një ndër trashëgimtarët dhe bashkëpronare e kësaj pasurie rezultoi edhe znj. L. B (nëna e subjektit).

Duket se kjo pasuri e paluajtshme është përfituar nga nëna e subjektit të rivlerësimit si bashkëpronare, para se subjekti të fillonte detyrën si magjistrate.

b. Pasuria apartament nr. ***, ndodhur në lagjen “****”, Fier, është e regjistruar në emër të shtetasit A. K (datë 10.3.2015). Bazuar në certifikatën e pronësisë datë 9.6.2014, kjo pasuri ka qenë e regjistruar në emër të disa bashkëpronarëve, duke përfshirë shtetasit L. B (nëna e subjektit) dhe S.K (gjyshja e subjektit). Kjo pasuri rezultoi e blerë nga shtetasi Rr. K në datën 29.6.2002 dhe më pas u ka kaluar trashëgimtarëve (ndër të tjerë, bashkëshortes S dhe vajzës L) pas çeljes së dëshmisë së trashëgimisë.

Kjo pasuri rezultoi se është fituar me anë të trashëgimisë nga gjyshja dhe nëna e subjektit të rivlerësimit, para se subjekti të fillonte detyrën si magjistrate.

3.5 Pavarësisht se rezultoi se fitimi i pronësisë së këtyre dy pasurive është bërë nga gjyshi i subjektit Rr. K dhe më pas është përfituar nga gjyshja dhe nëna e subjektit, Komisioni konstatoi se subjekti nuk i ka deklaruar këto pasuri në deklaratën *Vetting* si pasuri në përdorim (detyrim ky që rrjedh nga ligji nr. 84/2016).

3.6 Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti nuk i ka deklaruar këto pasuri në përdorim në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*, në përputhje me nenin 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016.

3.7 Lidhur me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kërkua të jepte shpjegime në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

3.8 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar: *“Lidhur me konstatimin se dy pasuritë e deklaruara në përdorim në pyetësonin standard nuk janë deklaruar në deklaratën Vetting, ju informoj se mosdeklarimi ka qenë keqkuptim i ligjit nga ana ime, pasi kam menduar se meqenëse pasuria ka qenë në bashkëpronësi të mamit, rrjedhimisht ajo nuk do të ishte objekt hetimi. Nuk kam pasur asnjë qëllim për t’i fshehur si pasuri, për aq kohë sa me pyetësonin standard kam depozituar edhe të gjithë origjinën e këtyre pasurive, përfshirë edhe kontratat e shitblerjes, përkatësisht: për pasurinë nr. ***, e llojit apartament banimi 2+1, me sip. 67.96 m², banesa nr. *** shk. ***, kati ***, ndodhur në lagjen ‘****’, Fier, kam dorëzuar kontratën e privatizimit në emër të gjyshit tim Rr.K e datës 15.9.1993; dhe për pasurinë e llojit apartament nr. ***, lagja ‘****’, kam dorëzuar kontratën e shitblerjes në emër të gjyshit tim Rr. K, e datës 29.6.2002.*

*Gjithashtu, ju bëj me dije se i kam deklaruar edhe në deklaratat periodike vjetore këto apartamente si adresë banimi të familjes, pasurinë e përfituar nga privatizimi, si dhe kam deklaruar në deklaratën Vetting edhe pasurinë e llojit apartament nr. ***, lagja ‘****’, Fier, si një adresë e përdorur nga ana ime për korrespondencë postare, duke qenë lehtësisht e identifikuar si adresë postare. Kjo tregon që nuk kam pasur asnjë qëllim fshehjeje apo mosdeklarimi të këtyre pasurive, por ka ardhur vetëm si pasojë e interpretimit jo të drejtë të detyrimit për t’i deklaruar ato.*

Dua të theksoj gjithashtu se apartamentet në fjalë janë privatizuar/blerë/paguar vetëm prej gjyshit tim, respektivisht 22 vite dhe 14 vite përpara emërimit tim si gjyqtare/stazhiere, si dhe janë realizuar në mungesën e ndonjë kontributi financiar nga ana ime (duke qenë se kam pasur moshën përkatësisht 7 vjeç dhe 16 vjeç), ndaj vlerësoj dhe kërkoj mirëkuptimin tuaj që kjo pakujdesi në kuptimin e drejtë të këtij detyrimi të mos përbëjë arsye për t’u konsideruar si shkelje.

Vlerësimi i Komisionit

3.9 Pas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, pavarësisht mosdeklarimit në deklaratën *Vetting* në mënyrë të saktë të këtyre pasurive në përdorim, Komisioni doli në përfundimin se shpjegimet e subjektit ishin të qarta dhe të plota.

4. Të tjera

4.1 Është administruar dokumentacioni shkresor bazuar në korrespondencën e mbajtur me institucionet shtetërore dhe private dhe me subjektin e rivlerësimit. Është kontrolluar i gjithë dokumentacioni i paraqitur nga bankat, ASHK, DPSHTRR, DPPPP, DPPSH, AMF, TIMS, FSHU etj., si dhe dosja e ILDKPKI-së.

4.2 Është verifikuar për ndonjë pasuri të mundshme të prindërve të subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të saj. Nga dokumentacioni i administruar në dosje dhe përgjigjet e institucioneve shtetërore dhe bankave nuk janë konstatuar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo likuiditete bankare në emër të familjarëve të subjektit të rivlerësimit për periudhën e deklarimit 2015 – 2017. Lidhur me gjendjen civile të subjektit dhe ndryshimet ndër vite, rezultoi se:

- subjekti ka qenë në certifikatë familjare me prindërit dhe vëllain deri në datën 20.10.2016;
- në datën 22.10.2016 rezulton në certifikatë familjare më vete;
- subjekti është martuar në datën 10.6.2019 me shtetasin D. Ll;
- fëmija A. Ll. ka lindur në datën 28.9.2019.

4.3 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar të ardhura të bashkëshortit nga shitja e pasurisë truall me sip. 800 m² në ***, Divjakë (Lushnjë) në vitin 2019, në vlerën 330,000 lekë.

4.4 Për këtë pasuri dhe burimin e krijimit u pyet subjekti e cila ktheu përgjigje⁴. Subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është blerë nga bashkëshorti në vitin 2017 në vlerën 120,000 lekë, me të ardhura nga tërheqja e depozitës bankare.

4.5 Nga verifikimi i kryer rezultoi se bashkëshorti i subjektit D. Ll. ka blerë një pasuri tokë truall me sip. 800 m², me anë të kontratës nr. ***/***, datë 28.8.2017, në vlerën 120,000 lekë. Më pas kjo pasuri është regjistruar në ZVRPP në emër të bashkëshortit të subjektit. Lidhur me burimin e blerjes së kësaj pasurie, nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti duket se ajo është blerë nga të ardhurat e depozitës bankare të bashkëshortit të subjektit. Kjo depozitë në vlerën 800,000 lekë është krijuar në datën 23.8.2013 dhe është mbyllur më 25.8.2017, ku është tërhequr edhe vlera përkatëse. Në datën 28.8.2017 është blerë nga bashkëshorti pasuria në fjalë, në vlerën 120,000 lekë.

4.6 Në përfundim të hetimit, Komisionit nuk i rezultuan problematika për këtë pasuri të bashkëshortit të subjektit, pasi rezultoi si pasuri e krijuar prej tij para martesë.

4.7 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar blerje të një automjeti tip “***” në vitin 2019, me targa AA ***.

4.8 DPSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2021, ka paraqitur praktikën që i përket automjetit tip “***”, të blerë nga subjekti i rivlerësimit.

4.9 Për blerjen e këtij automjeti rezultoi fatura tatimore nr. ***, datë 5.1.2019, në vlerën 180,000 lekë. Subjekti ka deklaruar se burimi për blerjen e kësaj pasurie është kredia bankare.

4.10 Rezultoi se në datën 4.1.2019 subjekti ka përfituar pranë “Raiffeisen Bank” një kredi bankare në shumën 420,000 lekë.

⁴ Shihni përgjigjen e subjektit në pyetësorin nr. ***.

4.11 Komisionit nuk i rezultuan problematika për këtë automjet të blerë nga subjekti në vitin 2019.

4.12 Komisioni hetoi lidhur me ndonjë situatë të mundshme të konfliktit të interesit të subjektit me personat:

- G. Ç. (subjekti ka banuar me qira për periudhën dhjetor 2015 - korrik 2016);
- E. B. (qiradhënësja e apartamentit 2015 - 2016);
- I. K. (qiradhënës i apartamentit për periudhën mars 2017 - shtator 2018);
- V. M. (qëndruar si mysafire në apartamentin e saj për periudhën nëntor - dhjetor 2015 dhe gusht - tetor 2016, në B, New York);
- R. dhe Sh. Xh. (qëndruar si mysafire në apartamentin e tyre për periudhën 1 nëntor 2016 - 31 maj 2017, në B, New York).

4.13 Bazuar në përgjigjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë (nr. *** prot., datë 15.3.2023) dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (nr. *** prot., datë 16.3.2023), rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndjekur apo gjykuar ndonjë çështje gjyqësore me këta shtetas, duke dalë në konkluzionin e mospasjes së konfliktit të interesit me ta.

5. Analiza financiare

5.1 Analiza financiare fillon në dhjetor të vitit 2015, meqenëse subjekti ka marrë emërimin si gjyqtare stazhiere në datën 20.11.2015 dhe rezultoi se subjekti ka udhëtuar jashtë Shqipërisë nga data 24.11.2015 deri më 3.12.2015.

Analiza financiare – subjekti Ersida E Bajgora, dhjetor 2015 – 31.12.2016

PËRSHKRIMI	Dhjetor 2015	2016	TOTAL
PASURI	-280	25,165	24,885
			0
Ndryshim në likuiditet	-280	25,165	24,885

DETYRIME	0	78,799	78,799
Kredi “Raiffeisen Bank”, viti 2016 - 103,000 lekë		78,799	78,799
			0

PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	-280	-53,633	-53,913
--	-------------	----------------	----------------

TË ARDHURA, dokumentuar	110,324	971,748	1,082,072
Të ardhura, subjekti Ersida Bajgora	110,324	971,748	1,082,072
			0
SHPENZIME	32,690	727,230	759,920
Shpenzime jetese	18,690	235,092	253,782
Shpenzime interesi kredia në “Raiffeisen Bank” - 2016		3,238	3,238
Shpenzime qiraje	14,000	98,000	112,000
Shpenzime udhëtimi		390,900	390,900

Analiza dokumentuar	77,914	298,151	376,065
	Pamundësi financiare		0

5.2 Nga analiza financiare duket se subjekti kishte mundësi financiare të mjaftueshme për shtimin e likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës dhjetor 2015 - 31.12.2016.

Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare

Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjen e likuiditeteve të subjektit dhe bashkëshortit, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga “Raiffeisen Bank” dhe “Credins Bank”

Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti deklaroi se ka pasur një llogari bankare në “C.B”, Philadelphia, SHBA, të cilën e ka çelur gjatë kohës së qëndrimit në vitin 2019. E pyetur për këtë, në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti deklaroi se kjo llogari është krijuar në gusht të vitit 2019 për të lehtësuar kryerjen e pagesave utilitare të përditshme në atë shtet dhe se me largimin e saj nga SHBA-ja në tetor të vitit 2019 nuk ka pasur gjendje të mbetur në llogari.

Lidhur me sa sipër, subjektit iu kërkuua të paraqesë të dhënat e kërkuara për këtë llogari bankare, e cila në përgjigje të rezultateve të hetimit vuri në dispozicion *statement*-in bankar të llogarisë në “C.B”, Philadelphia, SHBA, llogari e krijuar në gusht të vitit 2019⁵ dhe e mbyllur në dhjetor të atij viti, nga e cila rezultoi kryerja e pagesave utilitare të përditshme në SHBA.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen të ardhurat nga pagat e subjektit nga Shkolla e Magjistraturës (2013 – 2015) dhe si gjyqtare stazhiere tek Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (dhjetor 2015 – 31.12.2016).

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

- i) Shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT-i).
- ii) Shpenzime qiraje për vitet 2015 - 2016, sipas deklaramit të subjektit në përgjigje të pyetësorit standard.
- iii) Shpenzime interesi dhe principali të kredisë së marrë tek “Raiffeisen Bank” në vitin 2016.
- iv) Shpenzime udhëtimi për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi TIMS. Për përlogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit është zbatuar vendimi nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti ka deklaruar dhe dokumentuar udhëtime për qëllime pune dhe ato për të cilat janë dokumentuar qëndrim pranë njerëzve të afërm.

Referuar udhëtimit të bërë nga subjekti në SHBA në fund të muajit gusht 2016 deri në janar të vitit 2017 janë llogaritur shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit deri në datën 31.12.2016. Shpenzimet e transportit janë llogaritur sipas vendimit të sipërcituar.

Shpenzimet e qëndrimit në New York në fund të muajit gusht 2016 deri më 31.12.2016 janë llogaritur duke pasur parasysh informacionin e mëposhtëm:

- Deklaratën e subjektit se gjatë kësaj periudhe ajo ka qëndruar në banesat në pronësi të shtetasve V. M dhe R.Xh pa paguar qira. Sipas saj, tek shtetasja V.M nuk ka pasur as shpenzime qiraje dhe as shpenzime për ushqimin, ndërkohë tek banesa e R.Xh ka ndenjur pa qira, por shpenzimet e tjera i ka mbuluar vetë.

- Deklaratat noteriale të shtetasve V.M dhe Sh.Xh, të cilat deklarojnë se subjekti ka qëndruar në këtë periudhë në banesat në pronësi të tyre. Në këto deklarata noteriale konfirmohet

⁵ Bashkëlidhur subjekti ka paraqitur *statement*-in bankare të llogarisë në “C.B”, Philadelphia, SHBA (gjithsej *** faqe), si dhe *statement*-in e printuar në datën 8.4.2023, ku pasqyrohet data e hapjes dhe e mbylljes së kësaj llogarie.

qëndrimi i subjektit në banesat në pronësi të tyre pa qira, por nuk përmendet mbulimi i shpenzimeve të tjera të jetesës.

Subjekti deklaroi se si burim për shpenzimet e këtij udhëtimi dhe qëndrimit ka shërbyer kredia e marrë në “Raiffeisen Bank” në vlerën 103,000 lekë, *overdraft*-i i marrë pranë së njëjtës bankë në vlerën 240,000 lekë, si dhe një vlerë prej 60,000 lekësh që ajo dispononte *cash* në banesë para udhëtimit.

Nga *statement*-i i llogarisë së subjektit tek “Raiffeisen Bank” rezultoi se në datën 24.8.2016 subjekti tërheq vlerën prej 330,900 lekësh.

Referuar këtij informacioni janë llogaritur shpenzimet⁶ e jetesës së subjektit gjatë periudhës 25.8.2016 – 31.12.2016, duke zbritur shpenzimet e qirasë bazuar në faktin se për vitin 2016 këto shpenzime në New York zënë rreth 65.2%⁷. Vlera totale që rezultoi nga ky udhëtim, duke përfshirë udhëtimin e vajtjes në New York dhe qëndrimin deri në datën 31.12.2016 (235,499 lekë), duket se është më e ulët se vlera e deklaruar nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve si të shpenzuar për këtë udhëtim.

Për këtë arsye vlera e shpenzimeve për udhëtimin është lënë në vlerën totale prej 390,900 lekësh (330,900 + 60,000), siç është deklaruar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit.

ç. Vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e sipërmarrjeve/shitblerjeve të këtyre pasurive⁸.

Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit

6. Komisioni, në vlerësimin e çështjes në lidhje me kriterin e pasurisë, çmon se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë, nuk ka mungesë burimesh të ligjshme financiare, si dhe nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas përcaktimeve të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. DSIK-ja, si institucioni kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarameve të subjektit dhe të të dhënave të tjera, me qëllim përcaktimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 4 dhe neneve 37 dhe 38 të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur pranë Komisionit raportin përfundimtar nr. *** prot., datë 30.10.2017, ku rezultoi se:

- formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në përputhje me ligjin nr. 84/2016;
- subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklarama në deklaramen për kontrollin e figurës;
- për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të krimit të organizuar;
- konstatohet se subjekti i rivlerësimit Ersida Bajgora është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

1.1 Për pastërtinë e figurës nuk ka pasur të dhëna e dyshime bazuar në raportin e DSIK-së.

⁶ [Historical Poverty Tables: People and Families - 1959 to 2021 \(***.gov\)](#)

⁷ https://wp.***.com/streeteasy/2/StreetEasy-2016-Rent-AffordabilityReport-7e91e8.pdf

⁸ Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme në dosjen e ILDKPKI-së.

1.2 Me shkresën nr. *** prot., datë 9.2.2023, iu kërkua DSIK-së përditësimi dhe deklasifikimi i raportit të figurës për subjektin e rivlerësimit.

1.3 Në datën 28.2.2023 është paraqitur raporti i deklasifikuar plotësisht i DSIK-së (nr. *** vendimi, datë 23.2.2023), ku konstatohet se për subjektin Ersida Bajgora nuk disponohen të dhëna mbi përfshirjen e saj në veprimtari të kundërligjshme dhe konstatohet përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit.

Bazuar në faktet e sipërpërmendura:

- Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Subjektit i rivlerësimit e ka dorëzuar në kohë deklaratën e kontrollit të figurës sipas ligjit.
- Subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklaram të pasaktë dhe nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Vlerësimi i Komisionit për kriterin e figurës

2. Komisioni në përfundim vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Ersida Bajgora ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Ky raport është përgatitur bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

2. Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti; (ii) pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së.

3. Subjekti i rivlerësimit Ersida Bajgora në periudhën tetor 2013 – shtator 2015 ka ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës, ndërsa nga muaji nëntor i vitit 2015 ka kryer detyrën e gjyqtarës stazhiere në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4. Rezulton se Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. ***, datë 20.11.2015, ka dekretuar znj. Ersida Bajgora, kandidate për magjistrate, të emërohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Po kështu, me vendimin nr. ***, datë 10.2.2017, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vendosur të caktojë magjistraten Ersida Bajgora për të ushtruar funksionin e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Dokumenti 1 – vendimi civil nr. ***, datë 31.5.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket paditëses E. Gj, me të paditur shoqërinë “A.R.M.O” sh.a., me objekt “detyrim për dëmshpërblim për zgjidhje të kontratës së punës...”.

Dokumenti 2 – vendimi civil nr. ***, datë 1.3.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket paditëses L. K, me të paditur A.K, me objekt “zgjidhje martese dhe pasojat që rrjedhin prej saj”.

Në vendim nuk pasqyrohet data e regjistrimit të çështjes dhe nuk mund të konstatohet nëse është shqyrtuar brenda apo jashtë afatit standard 4-mujor të gjykimit të përcaktuar nga germa “d” e pikës 5 të vendimit të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

Për këtë gjetje subjektit iu kërkua të jepte shpjegime, e cila në përgjigje të rezultateve të hetimit sqaroi se lidhur me konstatimin se në vendimin civil nr. ***, datë 1.3.2016, nuk pasqyrohet data e regjistrimit të çështjes dhe nuk mund të konstatohet nëse është shqyrtuar brenda apo jashtë afatit standard 4-mujor të gjykimit të përcaktuar nga germa “d” e pikës 5 të vendimit të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, çështja është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 21.1.2016, ndërkohë që vendimi është shpallur në datën 1.3.2016, pra rezulton që kjo çështje është gjykuar⁹ në më pak se 2 muaj, brenda 38 ditëve.

Dokumenti 3 – vendimi penal nr. ***, datë 20.5.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket të pandehurit A.J, i akuzuar për veprën penale “vjedhje të energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, të parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal.

Pesë çështje të përzgjedhura me short

Dosja 1 – çështja civile nr. *** regj., datë 5.2.2016, që i përket paditësit N. I, me të paditur Y.I, me objekt “zgjidhja e martesës dhe rregullimi i pasojave të saj”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 3.6.2016.

Dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar janë depozituar nga gjyqtarja Ersida Bajgora në kryesekretari në datën 22.6.2016, pas 19 ditëve nga shpallja, jashtë afatit procedural civil 10-ditor të parashikuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Ersida Bajgora ka zgjatur gjithsej 3 muaj e 24 ditë, në intervalin kohor 9.2.2016 - 3.6.2016. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit 4-mujor të caktuar nga pika 5, germa “d” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Gjyqtarja ka marrë të gjitha masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për zgjidhjen brenda afatit të mosmarrëveshjes. Janë caktuar gjithsej 8 seanca, nga të cilat 5 seanca kanë qenë produktive. Pengesë për 3 seancat joproduktive është bërë mosparaqitja e të paditurës dhe mosparaqitja e psikologes. Seancat janë caktuar me distancë rreth 15 ditë nga njëra-tjetra. Në të gjitha seancat përgatitore e gjyqësore është dokumentuar orari i fillimit, nga nuk rezultojnë vonesa, por asnjëra prej tyre nuk është dokumentuar me regjistrim audio, në kundërshtim me udhëzimin nr. ***, datë 3.9.2013, të ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për marrjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio” dhe jo në funksion të transparencës dhe të solemnitetit.

Procesverbalet e të gjitha seancave përgatitore dhe gjyqësore nuk janë mbajtur dhe dokumentuar me regjistrim audio.

Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga neni 310 i Kodit të Procedurës Civile dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

⁹ Në cilësinë e provës subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues, fletët e regjistrimit për çështjen që i përket vendimit civil nr. ***, datë 1.3.2016.

Përmenden dhe analizohen në arsyetim të këtij vendimi norma të Kushtetutës, Kodit Civil, Kodit të Familjes, Kodit të Procedurës Civile, KEDNJ-së, vendimit të Gjykatës Kushtetuese, vendimit të Gjykatës së Lartë, vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë dhe Konventa Evropiane “Për të drejtat e fëmijëve”.

Gjyqtarja nuk ka përdorur në arsyetim ndonjë parim të së drejtës, por jurisprudencë të GJEDNJ-së dhe një standard të lartë në shkrimin e këtij vendimi.

Vendimi ka marrë formë të prerë, pa u ankimuar nga palët ndërgjyqëse.

Dosja 2 – çështja civile nr. *** regj., datë 18.1.2016, që i përket paditësit Sh. F, kundër të paditurit Ujësjetllës-Kanalizime Tiranë sh.a., me objekt “detyrimi i të paditurit të dëmshpërblejë paditësin për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 9.5.2016.

Në përfundim, gjykata ka shpallur: *Pranimin pjesërisht të padisë; detyrimin e palës së paditur UKT sh.a. t’i paguajë paditësit dëmshpërblim pagën e 4 muajve, 2 muajve, 6 muajve... Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera.*

Rezulton nga aktet në dosje se kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim paditësi Sh. F dhe pala e paditur UKT sh.a. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 10.7.2017, ka vendosur: *Ndryshimin e vendimit civil nr. ***, datë 9.5.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si vijon: detyrimin e palës së paditur UKT sh.a. të dëmshpërblejë paditësin Sh.F me 8 muaj pagë për zgjidhje të menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës; detyrimin e palës së paditur UKT sh.a. t’i paguajë paditësit Sh. F dëmshpërblimin për mosrespektim të afatit të njoftimit në masën 73,397 lekë, si diferencë e papaguar; rrëzimin për pjesën tjetër të padisë.* Edhe kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs paditësi Sh. F dhe pala e paditur UKT sh.a., por dosja që nga data 24.10.2017 ndodhet ende pa u shqyrtuar në Gjykatën e Lartë.

Dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, janë depozituar nga gjyqtarja Ersida Bajgora në kryesekretari në datën 30.5.2016, pas 21 ditëve nga shpallja, jashtë afatit procedural civil 10-ditor të parashikuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile, megjithëse gjykata ishte tërhequr për vendim me qëllim shpalljen e tij të arsyetuar. Gjyqtarja ka marrë të gjitha masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për zgjidhjen brenda afatit të mosmarrëveshjes. Janë caktuar gjithsej 11 seanca, nga të cilat 9 seanca kanë qenë produktive. Pengesë për 2 seancat joproduktive është bërë mosparaqitja e palës së paditur dhe kërkesa për shtyrje e palës paditëse. Seancat janë caktuar me distancë rreth 10 ditë nga njëra-tjetra dhe seanca e fundit për shpallje të vendimit është caktuar brenda afatit 5-ditor të parashikuar në nenin 308/2 të Kodit të Procedurës Civile. Konstatohet se asnjëra nga seancat nuk është dokumentuar me regjistrim audio dhe asnjëra prej tyre nuk ka filluar me vonesë, por mosdokumentimi me regjistrim audio është jo në funksion të transparencës dhe të solemnitetit në gjykim.

Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga neni 310 i Kodit të Procedurës Civile dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Gjyqtarja nuk ka përdorur shprehimisht në arsyetim ndonjë parim të përgjithshëm të së drejtës, por praktikë gjyqësore të Gjykatës Italiane të Kasacionit dhe një standard të lartë në shkrimin e këtij vendimi.

Dosja 3 – çështja civile nr. *** regj., datë 10.3.2016, që i përket paditësit E. B, kundër të paditurit A.Sh, me objekt “detyrimi i të paditurit të dëmshpërblejë paditësin për dëmin pasuror e jopasuror”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 13.6.2016.

Në përfundim të gjykimit gjykata ka shpallur: *Pranimin e kërkesëpadisë; detyrimin e palës së paditur të shpërblejë paditësin për dëmin pasuror dhe jopasuror të shkaktuar si pasojë e plagosjes së lehtë me dashje, në vlerën e përlogaritur nga ekspertët përkatës.*

Rezulton nga aktet në dosje se kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim i padituri dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 28.1.2020, ka vendosur: *Prishjen e vendimit nr. ***, datë 13.6.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.*

Sipas Gjykatës së Apelit, *vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i paarsyetuar dhe mbështetet mbi akte që janë marrë në kundërshtim me dispozitat procedurale civile.*

Rezulton nga aktet në dosje se edhe kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs dhe kundërrekurs nga palët ndërgjyqëse dhe dosja nga data 26.6.2016 ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Gjyqtarja ka marrë të gjitha masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes brenda afatit. Janë caktuar gjithsej 9 seanca, të cilat kanë qenë produktive. Të 9 seancat nuk janë dokumentuar me regjistrim audio, në kundërshtim me udhëzimin nr. 353, datë 3.9.2013, të ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për marrjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio” dhe jo në funksion të transparencës dhe të solemnitetit.

Përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kushtetutës, Kodit Civil, Kodit të Procedurës Civile, vendimit unifikues nr. 12, datë 14.9.2007, të Gjykatës së Lartë, urdhrit nr. ***, datë 16.3.2005, të ministrit të Drejtësisë, dhe praktika gjyqësore e Italisë. Gjyqtarja nuk ka përdorur shprehimisht në arsyetim parime të së drejtës.

Dosja 4 – çështja penale nr. *** regj., datë 17.3.2016, që i përket kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë kundër të pandehurit F. B, i akuzuar për veprën penale “vjedhje të energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, të parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 27.4.2016.

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 17.3.2016. Nga aktet në dosje rezulton se vendimi ka marrë formë të prerë, pa u ankimuar nga palët.

Dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, janë depozituar në kryesekretari nga gjyqtarja Ersida Bajgora në datën 16.5.2016, pas 19 ditëve nga shpallja, jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjyqtarja ka marrë të gjitha masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për shqyrtimin e saj, duke proceduar me gjykim të shkurtuar. Vendimi për caktimin e seancës së parë është marrë brenda 10 ditëve të parashikuar nga neni 333/1 i Kodit të Procedurës Penale. Janë caktuar 3 seanca gjyqësore, nga të cilat 2 kanë qenë produktive. Nuk mund të përcaktohet pengesa në seancën joproduktive, pasi nuk është çelur fare seanca gjyqësore. Në fillimin e 2 seancave gjyqësore të zhvilluara nuk ka pasur vonesë, por asnjëra prej tyre nuk është dokumentuar me regjistrim audio, jashtë funksionit të transparencës dhe të solemnitetit në gjykim.

Në dosje gjendet vendimi për kalimin e çështjes penale në gjykim, aktet e njoftimit të palëve, si dhe provat shkresore. Të dyja procesverbalet gjyqësore të administruara në dosje nuk janë të plota, pasi mungojnë gjeneralitetet e të pandehurit, siç përcakton neni 345/1/ç i Kodit të Procedurës Penale. Megjithatë rezultojnë të pasqyruara të gjitha përshkrimet për veprimet procedurale të kryera, konform kërkesave të nenit 346 të Kodit të Procedurës Penale (konstatohet i pasqyruar në një rast emri i prokurorit si i pandehur).

Përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale, vendimi unifikues nr. 2, datë 29.1.2003, i Gjykatës së Lartë, vendimi nr. 19, datë 1.6.2011, i Gjykatës Kushtetuese dhe vendimi nr. ***, datë 6.11.2013, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Gjyqtarja nuk ka përdorur ne arsyetim shprehimisht parime të përgjithshme të së drejtës.

Dosja 5 – çështja administrativo-penale me nr. *** regj., datë 18.5.2016, që i përket personit nën hetim A.K, me objekt “vleftësimi i ligjshëm i arrestit në flagrancë dhe caktimi i masës së sigurimit ‘arrest në burg’”, parashikuar në nenin 238 të Kodit të Procedurës Penale, e përfunduar me vendimin nr. *** akti, datë 19.5.2016.

Rezulton nga aktet në dosje se kundër vendimit të subjektit ka ushtruar ankim personi nën hetim dhe Prokuroria. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 17.6.2016, ka vendosur: *Miratimin e vendimit penal nr. *** akti, datë 19.5.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

Gjyqtarja ka marrë masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për shqyrtimin e saj, brenda afatit ligjor. Vendimi për caktimin e seancës gjyqësore është marrë menjëherë me depozitimin e kërkesës së prokurorisë. Në fillimin e seancës gjyqësore nuk ka pasur vonesë, por seanca është dokumentuar pa regjistrim audio, jo në funksion të transparencës dhe të solemnitetit në gjykim.

Në dosje gjendet vendimi për caktimin e seancës gjyqësore, aktet e njoftimit dhe të përfaqësimit, si dhe provat e tjera shkresore. Procesverbali gjyqësor i administruar në dosje nuk është i plotë, pasi mungojnë gjeneralitetet e personit nën hetim, konform nenit 245/a të Kodit të Procedurës Penale.

Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural penal, sipas nenit 245 të Kodit të Procedurës Penale. Në përfundim të shqyrtimit, gjykata ka mbërritur në përfundimin se arrestimi në flagrancë i personit nën hetim është kryer konform kriterëve ligjore, ndërsa masa e sigurimit “arrest në burg” nuk i përshtatet kërkesave dhe kriterëve të parashikuara nga nenet 228 dhe 229 të Kodit të Procedurës Penale.

Përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kushtetutës, Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale, vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë, vendimi nr. 11, datë 23.4.2009, i Gjykatës Kushtetuese, vendimi unifikues nr. 4, datë 14.11.2011, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ligji nr. 10494, datë 22.12.2011, “Për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet liria me vendim gjyqësor” dhe praktika e GJEDNJ-së. Gjyqtarja nuk ka përdorur shprehimisht parime të përgjithshme të së drejtës.

Të dhëna nga burime arkivore të KLGJ-së

5. Nga analiza e të dhënave në dosjen personale konstatohet se gjyqtarja Ersida Bajgora ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës, në datën 26.3.2010 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2016. Pas studimeve, në datën 10.2.2017, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, ku vazhdon edhe aktualisht.

6. Lidhur me të dhënat nga regjistri i ankesave dhe atij të procedimeve disiplinore rezultojnë gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Ersida Bajgora nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e KLD-së dhe, sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, nuk rezultojnë të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor.

Analiza e gjetjeve

7. Subjekti i rivlerësimit Ersida Bajgora ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, por, megjithëse njeh parimet e përgjithshme të së drejtës së procesit të rregullt ligjor, nuk i zbaton ato në praktikë. Rezulton se në të gjitha rastet u konstatua se ka përdorur referenca nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë (dhe më rrallë jurisprudencë të Gjykatës Kushtetuese).

8. Nga ana tjetër, ndër 3 dokumentet e përzgjedhura dhe 5 dosjet e vëzhguara janë ankimuar 3 prej tyre. Në një rast, Gjykata e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit sa i përket masës së dëmshpërblimit, në rastin e dytë ka vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes civile për rishqyrtim dhe në rastin e tretë ka vendosur miratimin e vendimit për masën e sigurimit personal të caktuar, ndërsa në 5 rastet e tjera nuk është ushtruar ankim nga palët.

9. Subjekti i rivlerësimit Ersida Bajgora ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej saj, në përgjithësi, janë të qarta dhe të kuptueshme. Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Vendimet përfundimtare të saj plotësojnë, sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural civil apo kërkesat e legjislacionit procedural penal.

10. Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës, në raport me pretendimet e ngritura nga palët.

11. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast nga 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara që të jetë cenuar vendim nga Gjykata e Apelit ose Gjykata e Lartë, për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Vetëm në një rast ka rezultuar se është prishur vendimi i shkallës së parë si i paarsyetuar dhe i mbështetur mbi akte që janë marrë në kundërshtim me dispozitat procedurale civile.

12. Në periudhën 20.11.2015 – 8.10.2016 subjektit i janë caktuar gjithsej 130 çështje, ka përfunduar gjithsej 127 çështje, si dhe ka mbartur në vitin 2017 gjithsej 3 çështje të vitit 2016.

13. Sipas pikës 3, germa “a” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtarja e gjykatës së shkallës së parë, që nuk është e organizuar në seksione, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në një vit në jo më pak se 200 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundërvajtje) dhe çështje civile me palë kundërshtare. Sipas të dhënave statistikore konstatohet se ngarkesa sasiore e gjyqtarës Ersida Bajgora me 28 çështje të tilla ka qenë nën standardin minimal.

14. Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja Ersida Bajgora ka qenë gjithnjë brenda afateve standarde apo ligjore.

15. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja Ersida Bajgora nuk i kushton gjithmonë rëndësi arsyetimit në kohë të shpejtë të vendimeve, për të mos pasur vonesa edhe brenda afateve ligjore. Kështu, vendimet janë arsyetuar prej saj pas 1 dite, pas 7 ditëve, pas 19 ditëve dhe pas 21 ditëve. Pra, vetëm dy prej pesë dosjeve janë dorëzuar në kryesekretari brenda afateve ligjore.

16. Subjekti i rivlerësimit Ersida Bajgora ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Janë vëzhguar 32 seanca gjyqësore, nga të cilat 26 kanë qenë produktive. Pengesë në 6 seanca joproduktive kanë qenë: mosparaqitja e të paditurit (3 seanca); mosparaqitja e psikologes (1 seancë); kërkesa për shtyrje e palës paditëse (1 seancë); dhe mosçelja fare e seancës gjyqësore (1 seancë).

17. Gjatë gjykimit identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra e vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre.

18. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se ato kanë qenë të rregullta dhe të plota nga ana formale. Për veprimet e kryera në seancë përgatitore apo gjyqësore është mbajtur procesverbal gjyqësor, bazuar në dispozitat procedurale civile ose ato penale. Të gjitha procesverbalet e seancës përgatitore dhe ato gjyqësore të administruara në dosje rezulton se janë të plota, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera, me përjashtim të dosjes penale 4, në të cilën u konstatua se mungonte një nga procesverbalet e seancës gjyqësore, e caktuar për t'u zhvilluar në datën 6.4.2016. Gjithashtu, në këtë dosje, dy procesverbalet gjyqësore të administruara në dosje nuk janë të plota, pasi mungojnë gjeneralitetet e të pandehurit, siç përcakton neni 345/1/ç i Kodit të Procedurës Penale.

19. Në të gjitha rastet e çeljes së seancave gjyqësore, në çështjet civile apo penale, është konstatuar në procesverbal se nuk janë dokumentuar me regjistrimin audio, në shkelje të transparencës dhe solemnitetit në gjykim.

20. Në përfundim të hetimit, për gjetjet e konstatuara nga Komisioni lidhur me 5 çështjet e përzgjedhura me short, subjektit iu kërkua të jepte shpjegime në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

21. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, lidhur me analizimin e 5 çështjeve të përzgjedhura me short, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar si vijon:

21.1 Sa i përket konstatimit se nuk janë dokumentuar me regjistrim audio gjatë kohës që ka kryer stazhin profesional pranë kësaj gjykate, ka shpjeguar se ka qenë evidente mungesa e sallave të gjykimit dhe e atyre ku mundësohej regjistrimi audio. Në këtë gjykatë, sallat e gjykimit me regjistrim audio kanë qenë të planifikuara sipas një kalendari të caktuar për t'u shfrytëzuar nga gjyqtarët që ushtronin detyrën në të.

21.2 Sa i përket konstatimit se dy procesverbalet gjyqësore të administruara në dosje (konkretisht, çështja penale nr. *** regj., datë 17.3.2016 dhe çështja nr. *** regj., datë 18.5.2016) nuk janë të plota, pasi mungojnë gjeneralitetet e të pandehurit, siç përcakton neni 345/1/ç i Kodit të Procedurës Penale, subjekti ka sqaruar se procesverbalet janë përgatitur nga sekretaria gjyqësore si një detyrim i saj dhe janë vlerësuar në tërësinë e tyre edhe duke qenë se gjeneralitetet janë një element që prezumohej se çdo sekretare gjyqësore duhej ta dinte, nga ana e subjektit është vlerësuar si një element i njohur dhe është prezumuar i realizuar.

21.3 Sa i përket konstatimit se gjyqtarja Ersida Bajgora nuk i kushton gjithmonë rëndësi arsytimit në kohë të shpejtë të vendimeve, për të mos pasur vonesa dhe brenda afateve ligjore, ajo ka sqaruar se këto vonesa në pjesën më të madhe kanë ardhur për shkak të nevojës së kryerjes së procedurave administrative nga sekretarja gjyqësore, si numërtimi, qepja e dosjes, hedhja në sistem, anonimizimi, dorëzimi fizikisht në kryesekretari etj.

21.4 Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se si gjyqtare në periudhën e stazhit profesional i ka kushtuar gjithë rëndësinë e duhur realizimit të një procesi në përputhje me standardet e procesit të rregullt ligjor në përputhje me përfundimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm dhe gjithashtu edhe arsytimit sa më të qartë dhe të mbështetur nga ana ligjore dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë apo edhe referime në jurisprudencën e GJEDNJ-së (siç edhe është konstatuar nga Komisioni).

21.5 Subjekti ka vlerësuar se rëndësia e dorëzimit në afat e vendimit është një detyrim ligjor dhe rëndësia e të cilit lidhet me të drejtën e palëve për realizimin e të drejtave subjektive siç është edhe ajo e ankimimit të vendimit dhe këto vonesa, të cilat janë vetëm disa ditë, nuk kanë ndikuar aspak dhe nuk kanë cenuar të drejtat e palëve në proces.

21.6 Sa i përket konstatimit se subjekti i rivlerësimit Ersida Bajgora ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, por, megjithëse njeh parimet e përgjithshme të së drejtës së

procesit të rregullt ligjor, nuk i zbaton ato në praktikë, ajo ka sqaruar se në të gjitha rastet janë përdorur referenca nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe nga GJEDNJ-ja, pasi natyra e çështjeve dhe çështjet ligjore të shtruara para gjykatës kanë qenë të tilla ku jurisprudenca e sipërcituar mund dhe duhej përdorur.

21.7 Sa i përket konstatimit se për vendimin nr. ***, datë 13.6.2016, Gjykata e Apelit ka vendosur prishjen e vendimit me argumentin se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i paarsyetuar, subjekti ka sqaruar se vendimi në fjalë është marrë plotësisht në përputhje me një vlerësim të plotë ligjor të fakteve dhe provave të marra gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe arsytimi i këtij vendimi ka qenë ashtu si dhe në vendimet e tjera, bazuar pikërisht në faktet, pretendimet dhe provat e paraqitura, si dhe duke i vlerësuar ato në përputhje me ligjin dhe me jurisprudencën detyruese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe asaj të Gjykatës Kushtetuese. Vendimi në fjalë përbëhet prej 19 faqesh së bashku me lëshimin e urdhrit të ekzekutimit dhe duke qenë se objekt i tij ka qenë shpërblimi i dëmit pasuror dhe jopasuror janë trajtuar gjerësisht elementet e dëmit pasuror dhe jopasuror dhe referuar rastit konkret është dhënë edhe zgjidhja përkatëse. Megjithatë, duke qenë se aktualisht pas rekursit çështja ndodhet në Gjykatën e Lartë, subjekti vlerëson se vendimi i marrë¹⁰ prej saj sa i përket arsytimit do të vlerësohet si i arsytuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese lidhur me arsytimin e vendimeve gjyqësore¹¹.

22. Në analizë të shpjegimeve të subjektit, Komisioni i vlerësoi ato bindëse dhe të bazuara në prova.

DENONCIME

23. Për subjektin e rivlerësimit Ersida Bajgora janë paraqitur 4 denoncime.

23.1 Ankesë e shtetasit A. H (nr. *** prot., datë 30.4.2021, nr. *** prot., datë 15.5.2021 dhe nr. *** prot., datë 7.6.2023). Ankuesi denoncon për shkelje ligjore, procedurale dhe të afateve nga subjekti i rivlerësimit. Meqenëse këto ankesa të A. H. i janë adresuar në vitin 2021 edhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Komisioni kërkoi pranë këtij organi informacion lidhur me ecurinë e mundshme dhe vendimmarrjen lidhur me këto ankesa (shkresa nr. *** prot., datë 13.2.2023).

ILD-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 20.2.2023, ka kthyer përgjigje ku thekson se pas shqyrtimit të kërkesave të shtetasit A. H. është vendosur arkivimi i ankesave. Në pjesën arsytuese të vendimit ILD-ja arsyeton se: *“Pretendimet e ankuesit ndaj magjstrates Ersida Bajgora në thelb janë pretendime të cilat lidhen me mënyrën e zgjidhjes së çështjes gjyqësore nga gjykata respektive”*. Shqyrtimi dhe vlerësimi i pretendimeve të palëve gjatë një procesi gjyqësor është atribut i pushtetit gjyqësor. Referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, ligjit nr. 49/2012, *“Për gjykatat administrative...”*, trajtimi i pretendimeve për zbatim të gabuar apo mosrespektim të legjislacionit procedural ose material gjatë shqyrtimit gjyqësor është kompetencë e gjykatave më të larta, në rast të ushtrimit të mjeteve procedurale të ankimit/rekursit të parashikuara në ligjet e sipërcituara.

¹⁰ Në cilësinë e provës subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues, vendimin nr. ***, datë 13.6.2016.

¹¹ Vendimi nr. 27, datë 24.6.2013, i Gjykatës Kushtetuese ku lidhur me standardin dhe arsytimin e vendimit gjyqësor kjo gjykatë argumenton se vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Vendimet gjyqësore duhet të përmbajnë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsytimi i vendimit në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive.

Për sa më sipër, nuk janë evidentuar shkelje të subjektit të rivlerësimit për këtë çështje që lidhet me ankuesin A. H.

23.2 Denoncim i shtetasit M.V (nr. *** prot., datë 6.8.2018). Denoncuesi nuk ka paraqitur informacion, shpjegime apo ndonjë vendim gjyqësor për t'u analizuar. Por bashkëlidhur praktikës rezulton një kopje e shkresës së Ministrisë së Drejtësisë (nr. *** prot., datë 20.7.2018) ku theksohet se: *“Rezulton se vendimi është shpallur në datën 25.5.2018 dhe ende nuk është dorëzuar në sekretarinë e gjykatës nga gjyqtarja Ersida Bajgora edhe pse kanë kaluar 1 muaj e gjysmë, në shkelje të afatit ligjor të parashikuar në nenin 308/2 të Kodit të Procedurës Civile”*.

Për këtë konstatim dhe mosrespektim të afatit ligjor prej 20 ditësh të depozitimit të vendimit në sekretarinë e gjykatës, subjektit iu kërkua të jepte shpjegime në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

23.3 Denoncim i shtetasit D.B (nr. *** prot., datë 5.12.2018). Ky shtetas denoncon subjektin e rivlerësimit për vonesa në zbardhjen e vendimit.

Për këtë çështje Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 13.2.2023, kërkoi kopje të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë (vendimi nr. *** , datë 17.5.2018).

Kjo gjykatë, me shkresën nr. *** prot., datë 14.2.2023, vuri në dispozicion kopje të praktikës dhe informacionin e kërkuar.

Rezultoi se kjo çështje është regjistruar në gjykatë në datën 16.1.2018 dhe vendimi nga subjekti i rivlerësimit është dhënë në datën 17.5.2018. Vendimi është dorëzuar i arsyetuar nga subjekti në datën 15.10.2018 dhe dosja është dorëzuar në kryesekretari në datën 23.10.2018.

Rezultoi se subjekti nuk ka respektuar afatin ligjor të zbardhjes së vendimit gjyqësor.

Për këtë konstatim lidhur me mosdorëzimin brenda afatit ligjor të vendimit të arsyetuar, subjektit iu kërkua të jepte shpjegime në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit për dy denoncimet e mësipërme

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar lidhur më këto dy denoncime të shtetasve M. V dhe D. B për vonesën në zbardhjen e vendimeve, ku sqaron se vonesa ka ardhur si rezultat i një ngarkese tepër të lartë.

Subjekti thekson se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka filluar punë në datën 21.2.2017 dhe pothuajse për të gjithë vitin 2017 ka përballuar një ngarkesë prej 75% të dosjeve të shortuara, kjo pasi kishin mbetur vetëm dy gjyqtarë që ushtronin detyrën, nga pesë që ishte organika.

Vetëm për vitet 2017 dhe 2018 subjekti sqaron se ka gjykuar rreth 1550 çështje, nga totali prej 4400 i të gjitha çështjeve të regjistruara në këtë gjykatë.

Vonesat në dorëzimin e vendimeve janë trajtuar edhe nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në kuadër të verifikimit të informacionit periodik të dërguar nga Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Nga gjithë analizimi i vendimeve të dorëzuara me vonesë, ku përfshihen edhe ato të shtetasve M. V dhe D. B, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vlerësuar se vonesat kanë ardhur si rezultat i ngarkesës së madhe të punës, kompleksitetit të çështjeve gjyqësore, gjendjes shëndetësore, si dhe vonesat nuk kanë sjellë pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në proces dhe se vonesat nuk janë jashtë çdo afati të arsyeshëm logjik dhe objektiv. Gjithashtu, ILD-ja ka referuar edhe në raportin vjetor të KLGJ-së për vitin 2018, në të cilin është konstatuar mbingarkesa e gjyqtarëve, fakt që nuk mund të pretendohet për shkelje disiplinore nga ana e gjyqtarëve për vonesa në dorëzimin e vendimeve të arsyetuara. Në nenin 101, pika 2, germa “d” e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

i ndryshuar, parashikohet se: “Në përcaktim të veprimit, mosveprimit apo sjelljes së magistratit si shkelje disiplinore, duhet të merret parasysh çdo situatë që është jashtë kontrollit të magistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor”.

Subjekti, gjithashtu, shpjegon se për të dyja vendimet, për të cilat është paraqitur denoncim, vonesa në dorëzimin e vendimeve nuk ka cenuar aspak të drejtat kushtetuese të palëve në proces, pasi palët kanë ushtruar të drejtën e ankimit sipas Kodit të Procedurës Civile.

Në përfundim, Komisioni vlerësoi se shpjegimi i subjektit të rivlerësimit ishte i qartë, i plotë dhe i mjaftueshëm

23.4 Denoncim i shoqërisë “*”** (nr. *** prot., datë 14.8.2019). Kjo shoqëri denoncon subjektin e rivlerësimit për mangësi të theksuara në kuptimin e ligjit “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”. Për këtë çështje, Komisioni kërkoi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë kopje të vendimit gjyqësor të përmendur nga shoqëria “***” në ankimin e saj. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me shkresën nr. *** prot., datë 14.2.2023, paraqiti kopje të vendimit gjyqësor nr. *** (***), datë 17.7.2019.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të ankuesit dhe vendimit gjyqësor të sipërpërmendur, Komisioni konstatoi se pretendimet e ankuesit janë pretendime që lidhen me mënyrën e zgjidhjes së çështjes gjyqësore nga gjykata respektive. Pavarësisht sjelljes së gjykatës në trajtimin e kësaj çështjeje, Komisioni shprehet se trajtimi i pretendimeve për zbatim të gabuar të legjislacionit material gjatë shqyrtimit gjyqësor është kompetencë e gjykatave më të larta. Në rastin konkret, denoncuesi ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila me vendimin e datës 24.9.2020 ka vendosur: *Lënie në fuqi të vendimit nr. *** (***), datë 17.7.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë*. Kjo çështje pritet të shqyrtohet nga Gjykata e Lartë pas rekursit të bërë.

Vlerësimi i Komisionit për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit

24. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në kuptim të germës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Ersida Bajgora ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, referuar germës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Ersida Bajgora, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 28.4.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU
Kryesuese

Roland ILIA
Relator

Genta TAFA (BUNGO)
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi